ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E PODUJEVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615–22–378–2–2–1**

Sa i përket tenderit për **Largimi i deponive ilegale**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P "Keni"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sveqël, pn.

(Adresa)

Podujevë **11000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

_+38349114885

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_ Hakif Jaha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ntp.keni1@gmail.com

(Adresa elektronike)

07.04.2022

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë: 31.01.2022
Data e hapjes së ofertave: 21.02.2022
Njoftim mbi vendimin e AK: 23.03.2022
Kërkesa për Ryshqyrtim: 25.03.2022
Vendim pezullimin e Aktivitetit: 29.03.2022
Vendimi I Ak. Refuzimi I Kerkeses : 30.03.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës se Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.25.03.2022 nga Operatori Ekonomik, **N.T.P."KENI"** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **"Largimi i deponive ilegale"** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-378-2-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar - Kërkesa për Rishqyrtim të dt.25.03.2022, parashtruar nga Operatori Ekonomik, **N.T.P."KENI"** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **"Largimi i deponive ilegale"** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-378-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 23.03.2022 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

Vërtetohet; Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 23.03.2022, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

AK - Ka pezulluar; Aktivitetin e prokurimit me dt.28.03.2022 dhe publikuar për të gjitha palët në platformën elektronike te e-prokurimit në ueb-faqën: https://e-prokurimi.rks-gov.net.

AK- Qëndron prapa, Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike te e-prokurimit në ueb-faqën: https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetimi

Operatori Ekonomik, **N.T.P."KENI"** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **"Largimi i deponive ilegale"** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-22-378-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 23.03.2022, Pas analizimit te pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë.

Më: 25.03.2022, ju parashtruet kërkesën për rishqyrtim me pretendimet se:

Pretendimi-1:

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e tuaj me: 23.03.2022, ku keni rekomanduar për kontratë OE N.N.T "BINI" ndërsa neve na keni shpallur si tenderues të eliminuar. Fillimisht ju sqarojmë se ju si AK keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:
Pika1.---OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet si tenderues i eliminuar
dhe jo të rekomandohet për kontratë pasi që i njeti nuk ka ofruar numer te bollshëm të punëtoreve siaps kerkesës në Dosjen e Tenderit si:
OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtor. Ne Oferten e OE, te shpalluar fitues nga ana juaj vetem 10 nga stafi janë punëtor, të tjertët janë staf menaxhues.

Përgjigjeje-1:

Operatori Ekonomik N.N.T "BINI" i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, gjithashtu edhe në pretendimin tuaj është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar dëshmin me listen e punëtorve se ka të angazhuar minimum 15 punëtorë dhe ka bashkangjitur të gjitha dëshmit e kërkuara.

Në Kushtët në DT për pjesëmarrje është kërkuar te:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtor.	**Lista me numër të puntorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE , kontrata e punës me punëdhënësin ose marrveshja për angazhim në këtë projekt**

Sipas kërkesës së kushteve të dosjes së tenderit AK-ja, nuk ka kërkuar që të ndahën në punëtorë administrate dhe punëtorë të tjerë pune sepse të gjithë janë punëtorë të kompanisë, andaj kemi kërkuar që: **OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtor. (pra gjthësejt është kërkuar minimum 15 punëtorë pamvarsisht profesioneve sepse nuk është kërkuar në** DT.)
Dhe dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista me numër të puntorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE , kontratat e punës me punëdhënësin ose marrveshja për angazhim në këtë projekt.
Që do të thotë se OE."BINI" ju ka përmbajtur kushteve në DT te, III.2.4) Kapaciteti teknik dhe professional dhe ***Dëshmia e kërkuar dokumentare.***
Andaj ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar.

Pretendimi-2:

Ju si AK na keni shpalluar te papergjegjshem per arsye te mungeses se referencave të punëve te ngjashme ne 3-vitet e fundit ne vlerë: 67,000.00 Euro, e cila nuk qëndron, sepse ne si OE kemi ofruar referenca të knaqshme të cilat e kalojn vleren e parashikuar nga ana e juaj si AK.
Ju me vendimin tuaj nuk e keni respektuar nenin 72 të LPP.paragrafin 1,2 dhe 3. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, pra ju nuk i keni zbatuar dispozitat e lartcekura të nenit 72 të LPP-së pasi që nuk keni kërkuar fare sqarime shtesë në lidhje me informacionet, duke e favorizuar OE te cilen e keni

rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa sa i përket arsyes tuaj për eliminimin tonë ku e keni cekur se:
Munngojn referencat e natyres së ngjeshme për tri vitet e fundit në vlerë prej 67,0000.00 €.
Ju sqarojmë se arsyet tuaja të lartcekura për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Arsyet tuaja për eliminimin tonë janë vetëm pretekst për të na eliminuar neve, andaj ky veprim nga ana juaj tregon qartë diskriminimin që po i bëni kompanisë tonë, ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm po eliminohemi me arsye të cilat nuk qëndrojnë fare. Nëse ju si AK do ti kishit analizuar në tërësi të gjitha dokumentet e prezantuar në ofertë nga ana jonë, atëherë shumë qartë do të bindeshit se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigjeje nr.2.

Në kushtët e DT është kërkuar te:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në vlerë minimale prej 67,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në furnizime të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit	**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.**

Të ndëruar ju e dini se kjo kontratë është shërbime, ndërsa ju keni dorzuar listen e kontratave të realizuara, por kjo listë e kontratave nuk i plotëson kërkesat e AK sepse në këtë listë jan vetëm tri kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021, këto tri kontrata janë shërbime të renditura në listë nr: 2; 3 dhe 7 dhe përafërsisht jan të natyrës së ngjashme dhe kanë vlerën **32,086.31 €,** ndërsa kontratat e ndërtimeve të kanalizimeve janë punë nuk janë shërbime të natyrës së ngjashme të tjera janë të realizuara më heret se tri vitet e fundit nuk mund të llogaritën sipas kërkesës së AK-së.
Duke u bazuar në nenin 69 të LPP-së dhe te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) se:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vleres se përcaktuar
Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, neni 69 i LPP.-së

Andaj ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar.

Pas analizimit te pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të dates 23.03.2022, konsiderohet se është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore **nuk qëndrojnë** dhe AK qendron prapa vendimit të tijë.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/l-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente në pajtim me nenin 109 te LPP-se.

Nr. 14-370/03-0023435/22
Dt. 30.03.2022
Podujevë

Menaxheri ZP
Rasim Fejza

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E PODUJEVËS - OPSTINA PODUJEVO

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK me: 23.03.2022, ku kan rekomanduar për kontrat OE N.N.T "BINI" ndërsa neve na kan shpallur si tenderues të eliminuar. me pretendimet te cilat nuk qendrojn.
Duke e favorizuat njëanshem OE N.N.T "BINI", edhe pse shkelen dispoziat ligjore themelore te LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Ankesen tonë AK as nuk e ka marr mundimin ta lexoj dhe shqyrtoj ne mënyr të drejt,por vetem jep një përgjigjeje tekstuale, në te cilen as që e ka shiquar fare as nje pretendim tonin. AK na shpall si tenderues te pasuksesshem me pretendimin që nuk ofrojm Referenca te mjaftueshme te puneve të ngjashme. Pretendime te cilat nuk qendrojn, sepse referencat tona e kalojn parashikimin e kerkuar ne Dosjen e Tenderit. Por shihet qartazi që favorizimi i OE-së ne fjal i ka bërë që as mos ta shfletojn dokumentacionin tonë të ofruar ne e Ofert,

Ju sqarojmë se AK na ka shpalluar te papergjegjshem per arsye te mungeses se referencave të punëve te ngjashme ne 3-vitet e fundit ne vlerë: 67,000.00 Euro , e cila nuk qëndron, sepse ne si OE kemi ofruar referenca të knaqshme të cilat e kalojn vleren e parashikuar
Me liste te projekteve dhe referenca te ofruara.

Lista e Projekteve të realizuara

Nr	Titulli i Projektit	Viti	Autoriteti	Vlera
9	Ndertimit fekal Repë dhe Polatë	2019/20	Podujevë	85,065.13 €
8	Largimi i deponive ilegale te mbeturinave	2016	Podujevë	6,891.97 €
7	Zgjerimi I shtrati te lumejve ne disa fshatra	2020	Podujevë	9,660.76 €
6	Ndertimi i kanalizimit fekal në fshatin Pakashtic e eprme	2017	Podujevë	122,819.18 €
5	Rrenimi i Objektit të ish Komitetit	2018	Podujevë	2,815.48 €
4	Zdherimi dhe Pastrimi I shtratit të lumenjve	2018	Podujevë	944.00 €
3	Zdherimi dhe Pastrimi I shtratit të lumenjve	2019	Podujevë	16,960.38 €
2	Mbyllja e gropave të rrezikshme në Shtedim dhe Dumnic	2019	Podujevë	5,465.17 €
1	Ndërtimi I kanalizimit felal në Repë dhe Pollat	2019	Podujevë	85,065.13 €
	TOTALI			335,687.20 €

NDËRMARRJA TREGTARE PRIVATE KENI Shpk PODUJEVË

Te gjitha keto jan te ofruara dhe dokumentura me Raportet Teknike dhe Referenca nga Organet Kontraktuese.

Andaj **duke ju** referuar **argumenteve dhe** fakteve **te** paraqitura **me** larte, **shkeljet** e **dispozitave te LPP-se** nga **AK dhe duke pare se OE NTP KENI** ka dorezuar tenderin **e përgjegjshem me** cmimin **me te** ulet kerkojm **qe** ankesa **te** aprovohet si e bazuar, **lenda te kthehet** ne rivleresim **dhe te rekomandohemi per** kontrate pasi qe **jemi OE e** përgjegjshem **me** cmimin **me të** ulet.duke iu referuar edhe LPP-se neni 60 paragrafi 1.1

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim dhe Ankesen ne OSHP në vlerë prej 5,000.00 euro. Duke

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*